

PROTOKOLL PËR VEPRIM NË SHKOLLAT E MESME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË VITIN E PARË NË VITIN SHKOLLOT 2020/2021

- ▶ Regjistrimi i nxënësve në shkollë të mesme të realizohet gjatë periudhës prej ora 07:00 – 19:00
- ▶ Shfrytëzimi i pajisjeve mbrojtëse, maska, doreza nga të gjithë të punësuarit në shkollë të mesme
- ▶ Organizimi i shërbimit për mbajtjen e rendit në shkollë të mesme, me qëllim të zbatimit të rendit dhe mbajtjen e distancës së nevojshme ne mes nxënësve minimum prej 2 metra para dhe mbrenda në shkollë edhe atë 2 kujdestarë para hyrjes në shkollë dhe dy kujdestarë në shkollë. Kujdestarët të angazhohen nga ana e të punësuarve në shkollë, ku do të vendos drejtori i shkollës së mesme
- ▶ Vendosja e shenjave të cilat orientojnë drejtimin e lëvizjes dhe respektimin e distancës minimale të nevojshme gjatë pritjes radh të nxënësve para dhe brenda në shkollë
- ▶ Mbajtja e distancës fizike prej 2 metrash ndërmjet nxënësve të pranishëm në hapësirë
- ▶ Organizimi i pranimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrim në përputhje me Konkursin me sigurimin e vendeve pranuese në përputhje me distancën e parashikuar dhe hapësirën me të cilën disponon shkolla
- ▶ Mundësimi i hyrjes së 1 deri 6 nxënësve në shkollë varësisht nga hapësira me të cilën disponon për pranimin e dokumenteve, në parim numri i nxënësve të jetë i barabartë me numrin e vendeve të lira
- ▶ Mundësimi i hyrjes së vetëm të nxënësit, jo edhe prindit të tij, në raste të veçanta nëse nxënësi parandalohet për arsye të justifikueshme mundësohet hyrja e vetëm 1 prindi/ kujdestari, i cili mban maskë mbrojtëse, shall, faculetë ku do të mbulojë gojën dhe hundën, të cilët hyjnë në shkollë
- ▶ Dorëzimi vetëm i dokumenteve të kompletuara në përputhje me kushtet në Konkurs, të bashkangjitura me Fletëparaqitje paraprakisht të plotësuar për regjistrim, të shkarkuar nga ueb faqja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- ▶ Vendosja e mjeteve dezinfektuese në hyrje të shkollës, si dhe para hapësirave ku bëhet regjistrimi i nxënësve, me qëllim që nxënësit të dezinfektohen gjatë hyrjes në shkollë dhe gjatë daljes nga shkolla
- ▶ Detyrimisht, rregullisht të dezinfektohen bankat dhe hapësira në shkollë. Me mjet dezinfektues i cili vepron ndaj virusëve sipas udhëzuesimit të prodhuesit
- ▶ Në fund të çdo dite detyrimisht të bëhet pastrim dhe denzinfektim mekanik me mjete të cilat veprojnë ndaj virusëve sipas udhëzimeve të prodhuesit, në mënyrë alternative të shfrytëzohet 0,5 % natrium hipoklorit (5% zbardhues për amvisëri i cili shfrytëzohet në masë 1:100) ose 70% alkool për dezinfektimin e sipërfaqeve të sipërme
- ▶ Mirëmbajtja e rregullt e tualeteve - mbajtjen e detyrueshme të evidencës për pastrimin e kryer dhe përdorimin e dezinfektuesve të lartpërmendur
- ▶ Shkollat e mesme të cilat kanë dy hyrje / dalje mund të organizojnë hyrje nga njëra anë dhe dalje nga ana tjetër
- ▶ Dorëzimi i dokumenteve nga ana e nxënësit, përkatësisht prindit/kujdestarit është sipas shkronjave të alfabetit – mbiemrit.

Për shkak të ruajtjes së shëndetit, u bëhet thirrje të gjithë nxënësve që t'i respektojnë masat parandaluese të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- ▶ Të jeni të durueshëm, prisni në radhë para shkollës dhe mbani distancë të paktën prej 2 metrash nga njerëzit përreth jush, para dhe në shkollë
- ▶ Respektoni rekomandimet e kujdestarit dhe hyni në shkollë një nga një, pra pasi që kujdestari të ju lejojë, përkatësisht pasi që nxënësi para jush të dalë nga shkolla
- ▶ Mos qëndroni në shkollë më shumë se 5 minuta
- ▶ Detyrimisht të mbani pajisje mbrojtëse (maskë, daculetë, shall) në të kundërtën nuk do t'ju lejohet të hyni në shkollë

FALEMINDERIT QË PO I RESPEKTONI MASAT, SEPSE NËSE MBRONI VETEN, JU MBRONI TË TJERËT!



Republika e Maqedonisë së Veriut
**Ministria e Arsimit
dhe Shkencës**